

**04.07.2024
Ora 11:04**

RENDI I DITËS

- 1. Projektvendim: “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: Pavlina Docaj, Jona Josifi, Madalena Koja**
 - 3.Përfaqësues të partive politike : Eridjan Salianji, Ivi Kaso, Shkëlqim Sulo**
Avokate Klodiana Gjyzari, Vangjel Dule

Z.I.Celibashi:Mirëdita të gjithëve! Atëherë, në seancën e sotme publike kemi në rend të ditës këto çështje: Projektvendim për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Himarë, zotit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, i propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Pika e dytë ka të bëjë me projektvendimin “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues, zotin Gentjan Muça anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, po të datës 14 maj 2023”.

***Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

Projektvendimi për “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë të Vau-Dejës, si edhe projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9 qershor 2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, i ndryshuar ky udhëzim. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Himarë, zotit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri.

Znj.P.Docaj: Zoti Dhionisios Beleri është propozuar nga subjekti zgjedhor “Koalicioni Bashkë Fitojmë” si kandidat për Kryetarin e Bashkisë Himarë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Ky kandidat ka depozituar formularin e dekriminalizimit brenda afateve ligjore, më pas nga ana jonë është proceduar me verifikimin pranë zyrë së gjendjes civile dhe asaj gjyqësore, më pas pasi është kryer verifikimi i të dhënave në formular dhe është konstatuar se nuk është në kushte të ndalimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në datën 25.05.2024, i është dhënë mandati si Kryetar i Bashkisë Himarë. Më pas është vijuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me një kërkesë, pra është paraqitur një kërkesë nga zoti Eugen Likaj në datën 26.06.2024 me anë të së cilës kërkohet konstatimi i përfunduar i parakohshëm i mandatit të kryetarit të zgjedhur së Bashkisë Himarë, zotit Dionis Beleri për shkak të dënimit penal të tij me 2 vite burgim nga Gjykata e Posacme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Më pas është proceduar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me një informacion të kërkuar Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëse është

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

marrë ndonjë vendim penal në ngarkim të këtij shtetasi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka kërkuar informacion Zyrës së Gjendjes Gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pikërisht për shtetasin Dionis Beleri. Në kthimin e përgjigjes Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar i ka kthyer Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i ka bashkëlidhur shkurtimin e vendimit nr.26, datë 25.06.2024 që është dhënë në ngarkim të shtetasit Dionis Beleri, në të cilën përcaktohet se ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës nr.14 datë 05.03.2024 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ku është vendosur deklarimi i fajtorit të pandehurit Pandeli Kokoveshi dhe Dionis Beleri për kryerjen e veprës penale korrupsion aktiv në zgjedhje në bashkëpunim dhe është dënuar me dy vite burgim. Në referim të nenit 2, pika 1, shkronja b e ligjit 138 të vitit 2015 përcaktohet se vepra penale korrupsion aktiv në zgjedhje, parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal hyn në kategorinë e veprave penale për kryerjen e të cilave persona të caktuar nuk mund të kandidojnë dhe as të zgjidhen në postet e deputetit të Republikës së Shqipërisë, kryetarit të bashkisë apo anëtarit të këshillit bashkiak, etj. Në nenin 10, pika 1, shkronja ç e ligjit për “Garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksionin publik”, përcaktohet se KQZ brenda kompetencave të veta, shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur, i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen. Në këto rrethana në vlerësojmë se, z.Beleri i zgjedhur Kryetar i Bashkisë Himarë nuk mund të ushtrojë këtë detyrë për shkak të ndalimeve që vijnë pikërisht nga ky ligj. Bashkëlidhur keni edhe projektvendimin përkatës.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

Z.I.Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëhere në lidhje me këtë çështje (mesa shoh kemi gjithë panelin që meriton kjo çështje për ta diskutuar) kështu që fjala është për këdo nga anëtarët e panelit.

Z.I.Kaso (Përfaqësues i PD-së): Përshëndetje zoti komisioner. Ashtu siç jam lajmëruar nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me projektvendimin, palët e interesuar në këtë shqyrtim administrativ është Koalicioni Bashkë Fitojmë në cilësinë e subjektit zgjedhor që ka propozuar kryetarin fitues të Bashkisë Himarë në zgjedhjet e vitit të kaluar dhe në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Koalicionit Bashkë Fitojmë sipas marrëveshjes së Koalicionit të depozituar, në këtë shqyrtim administrativ marr pjesë unë si përfaqësues ligjor i koalicionit si dhe zoti Vangjel Dule në cilësinë e Kryetarit të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut në bashkëfirmosjen e marrëveshjes së koalicionit, pra parti përbërëse në marrëveshjen e koalicionit, të cilët do të ilustrojnë këtu qëndrimin politik të koalicionit lidhur me këtë lloj vendimarrje që i është propozuar komisionerit sot për shqyrtim, si dhe avokate Klodiana Gjysari, e cila pas njoftimit që i është bërë siç do ta ilustrojë vetë avokatja nga ana e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqëson vetë subjektin e interesuar Fredi Belerin në këtë shqyrtim administrativ. Doja t'i jepja fjalën avokates për të ilustruar qëndrimin lidhur edhe me disa aspekte paraprake të shqyrtimit administrativ. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Nuk kemi ndonjë problem me përfaqësimin, të paktën flas në cilësinë si Komisioner Shtetëror, kështu që keni të gjithë lirinë për të prezantuar argumentet, qoftë ato ligjore por dhe të tjera. Shpresoj t'i qëndrojmë më së shumti argumentit ligjor lidhur me këtë çështje. Fjala është për ju e nderuar avokate.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

Znj.K.Gjysari(avokate): Paraprakisht kam një kërkesë për t'u lejuar për të marrë pjesë në seancën e sotme të subjektit Dhionisios Alfred Belerit, duke qenë se është palë e interesuar në këtë proces. Sipas nenit 88 të dispozitave të tjera të Kodit të Procedurave Administrative, i cili është ligji i zbatueshëm në veprimtarinë e Komisionit Qendror Zgjedhor, rezulton që ky subjekt nuk është njoftuar në lidhje me fillimin e procedurës, në lidhjen me veprimet hetimore që janë kryer gjatë kësaj procedure dhe për këtë shkak bazuar në nenin 42,87,88 të ligjit nr.44 të vitit 2015 për Procedurën Administrative të Republikës së Shqipërisë në referim të nenit 12, paragrafi 7 i ligjit të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Bashkëngjitur paraqes kërkesën dhe aktin e përfaqësimit të shtetasit Dhionisios Alfred Beleri, i cili kërkon të dëgjohet në këtë proces, t'i jepet mundësia për t'u njohur me aktet e procedimit, duke qenë se është subjekti i interesuar drejtpërsë drejti në lidhje me vendimarrjen. Kërkesën e kam me shkrim, po e depozitoj.

Z.I.Celibashi: Mesa kuptova ju kërkonit që të...

Znj.K.Gjysari(avokate): Që të njoftohet shtetasi Dhionisios Alfred Beleri në vendin ku është duke vuajtur dënimin. T'i dërgohet kopja e dosjes administrative në mënyrë që të ketë mundësinë të japë fjalën e tij, dhe shpjegimet e tij të merren parasysh në këtë procedurë pasi referuar nenit 90 të Kodit Procedural Administrative nuk mund të merret një vendim përfundimtar pa u dëgjuar subjekti i interesuar Dhionis Alfred Beleri sipas nenit 88 të Kodit Procedurave Administrative. Përmbajtja e Projektvendimit i cili është publikuar në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezulton se janë kryer disa veprime hetimore administrative nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pra ka filluar një procedurë administrative që me fillimin kësaj procedure duhet të njoftohej subjekti se po fillon një procedurë administrative

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

në mënyrë që t'i lihej mundësia që të paraqiste dhe ai argumentet e tij gjatë procedurës administrative. Në fazën që jemi rezulton të jetë përmbyllur procedura administrative pa ju dhënë mundësia jo vetëm që të njihet me faktin që është filluar një procedurë administrative, por dhe të japë mendimin e tij në lidhje me procedurën sepse mund të kenë argumente shtesë, mund të ketë prova dhe është në disponibilitetin e tij të shprehet në lidhje me këtë procedurë, e cila fillon dhe përfundon me emrin e tij. Kjo ishte kërkesa ime procedurale.

Z.I.Celibashi: Dakord. E kuptova kërkesën tuaj shumë mirë. Me pak fjalë ju jeni duke thënë që subjekti dhe deklaruesi, ose të themi personi i interesuar drejtpërsëdrejti për këtë çështje nuk ka marrë njoftim dhe nuk ka dijeni për fillimin e kësaj procedure administrative. Paraprakisht dua të sqaroj që kjo procedurë administrative nuk ka përfunduar. Ne jemi në shqyrtim, jemi në proces administrativ dhe për këtë arsye kemi ftuar palët për të dhënë kontributet dhe argumentet e tyre në këtë proces administrativ. Përtej kësaj pyetje që kam unë, juve e përfaqësoni apo nuk e përfaqësoni. Nëse nuk e përfaqësoni zotin Beleri është një çështje tjetër. Nëse keni ardhur këtu si përfaqësuese e zotit Beleri, mendoj që i keni të gjitha tagrat, nëse jua kanë dhënë këto tagra për ta përfaqësuar në këtë procedurë administrative. Nëse kërkon që tej asaj që ju i keni të gjitha tagrat, doni që edhe ai të thotë diçka...

Znj.K.Gjysari(avokate): Faleminderit. Unë i kam tagrat për të nënshkruar aktet e përfaqësimit që kam dorëzuar të datës së djeshme, por njoftimi i KQZ-së është bërë në faqen publike të saj ditën e djeshme mbasdite dhe afati nga dje deri më sot ka qenë shumë i shkurtër për zotin Beleri për t'u njohur, përveçse nuk i janë komunikuar asnjë akt atij personalisht. Unë kam tagrat për të përfaqësuar, por nuk kam tagrat për të thënë fjalën e tij të fundit. Ajo është ekskluziviteti i tij. Unë kam tagra për të nënshkruar akte për ta përfaqësuar sipas akteve të përfaqësimit përpara çdo organi

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

administrativ, por në kushtet që jemi aktualisht, afati i lënë 24 orë nga KQZ-ja është shumë i shkurtër dhe nuk parashikohet nga ndonjë dispozitë të kodit të procedurës administrative apo të kodit zgjedhor një afat kaq i shkurtër për t'i dhënë mundësi subjektit, emri i të cilit është nga fillimi deri në fund I procedurës që të njihet me procesin dhe të japë mendimin e tij. Unë nuk kam patur mundësi të konsultohem me klientin në kushtet kur afati ishte vetëm 24 orë nga dje për sot dhe sot duhet të paraqiteshim përpara KQZ-së. Dhe do të ishte për një hetim të plotë t'i jepej mundësia, të njoftohej me shkresë në IKP-në ku ndodhet dhe t'i jepej mundësia në rast se do të paraqitet personalisht apo jo përpara KQZ-së të shprehë mendimin e tij.

Z.I.Celibashi: Mirë, dakord. Kuptova që ju e keni tagrin e përfaqësimit jo të plotë nga zoti Beleri. Do të pranojmë këtë me qëllim që mua të më jepet e drejta për të pranuar kërkesën tuaj që zoti Beleri të dëgjohet. Nëse duhet të pranojmë këtë, shkojmë tek e dyta....

Znj.K.Gjysari(avokate): Zoti Beleri kërkon që të njoftohet.

Z.I.Celibashi: Ajo çfarë jeni njoftuar, çfarë është bërë dje publike nuk ka të bëjë ajo është thjesht pjesë e një veprimtarie të brendshme administrative të Administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e cila ka vlerësuar në shqyrtimin e kësaj çështje komisionerit i rekomandohet të marrë këtë vendim por nuk ka shqyrtim administrativ, shqyrtim administrativ fillon tani. Nuk ka rëndësi nëse ju kërkon që ai të jetë prezent, nuk ka asnjë lloj problem, ne e shtyjmë.

Znj.K.Gjysari(avokate): Unë kërkoj të respektohet e drejta e tij për t'u njoftuar.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

Z.I.Celibashi: Është njoftuar, ne njoftimet i kemi dërguar ditë më përpara, ai ka dijeni për seancën për procesin administrativ që është zhvilluar kundrejt tij.

Znj.K.Gjysari(avokate): Në dijeninë time time në IEVP Fier nuk është dërguar asnjë shkresë.

Z.I.Celibashi: Ju nga e keni marrë dijeninë?

Znj.K.Gjysari(avokate): Nga televizori.

Z.I.Celibashi: Keni komunikuar gjatë kësaj periudhe me zotin Beleri?

Znj.K.Gjysari(avokate): Pasi morrëm dijeni nga televizori vajta mora prokurë dhe më ka njoftuar që nuk ka njoftim për seancën e sotme.

Z.I.Celibashi: Nuk ka njoftim për seancën e sotme apo për atë çfarë u publikua dje?

Znj.K.Gjysari(avokate): As për atë çfarë u publikua dje as për procedurën që është ndjekur deri tani, konkretisht nuk është njoftuar asnjë akt asnjë vendim nga KQZ-ja që ka filluar kjo procedurë administrative. Në qoftë se ka ndonjë njoftim administruar prej jush që në IEVP-në Fier ka shkuar një njoftim nga ana e KQZ-së për fillimin e kësaj procedure, atëherë unë nuk jam e informuar. Por mua kaq më ka informuar zoti Beleri që në IEVP-në ku ai ndodhet nuk i është dërguar asnjë akt nga KQZ-ja si në fillimin e procedurës administrative dhe për projektvendimin e sotëm i cili bazohet neni 90 që është përfundimi i procedurës administrative.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

Z.I.Celibashi: Ua sqaroj dhe një herë nuk ka filluar fare, nuk e kemi marrë vendimin për këtë çështje. Nuk ka përfunduar procesi administrativ dhe kjo është e qartë.
Po zoti Salianji!

Z.E. Salianji(Përfaqësues i PS-së): Megjithatë përsa i përket kësaj kërkesë do të thoja që aktet formalisht janë njoftuar prej disa ditësh subjekteve politike si në rastin konkret Partisë Socialiste por në të njëjtin email është edhe kolegu Kaso i cili ka marrë njoftim që përfaqëson koalicionin atë çfarë vet parashtrori, përfaqëson dhe kandidatin si dhe njoftimi i bërë publik. Pra nga ana formale unë e gjykoj që ju si KQZ e keni ushtruar të drejtën e informimit dhe ka pasur mundësi ndërmjet partisë që e ka propozuar koalicioni subjekti si dhe është marrë njoftimi dhe nga kandidati si dhe njoftimi është publik. Tani se bëhet kërkesa që ai të vijë këtu të sqarojë procesin unë besoj që avokatja është këtu, përfaqësuesi i koalicionit që e ka firmosur për të kandiduar është këtu vazhdojmë seancën e nuk ka asnjë shkak për shtyrje, njoftimi siç e ka procedura me njoftim publik dhe vet organi Partia Demokratike është njoftuar për këtë mbledhje të sotme para tre ditësh.

Z.I.Celibashi: Zonja thotë se nuk ka njoftim pala drejtpërdrejt e interesuar, ky është pretendimi që thotë avokatja me ato tagera që ka për të thënë aq sa tha sepse na deklaroi që nuk e ka tagerin e plotë që sot ta përfaqësojë zotin Beleri në të gjitha të drejtat e veta.

Z.E.Salianji: E kemi Partinë Demokratike që e ka propozuar zotin Beleri dhe Partia Demokratike thotë që nuk ka komunikim me kandidatin e saj atëherë hajde e diskutojmë, unë nuk e shikoj këtë problem procedural për ta shtyrë mbledhjen. Në qoftë se këtu nuk do të ishte njoftuar Partia Demokratike atëherë ishim përballë faktit

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

të mosnjoftimit, vetë zoti Beleri këtu nuk po bëjmë gjyqin e qytetarit e zotit Beleri jam shumë dakord. Këtu po bëjmë seancë publike për kandidatin e Koalicionit Bashkë Fitojmë zotin Beleri, i cili është pjesë zoti Kaso që ka marrë njoftim rregullisht. Në qoftë se do të ishte procedurë administrative personale atëherë jam dakord me avokaten që çështja mund të shtyhet, por sot po diskutojmë kandidatin e koalicionit Bashkë Fitojmë, i cili përfaqësohet nga koalicioni dhe njoftimi është i mundshëm. Pra njoftimi thuhet kur nuk ka mundësi njoftimi atëherë subjekti e ka marrë njoftimin, njoftimi është bërë publik dhe avokatja thotë se është marrë njoftimi atëherë ne mundet të vinim në dispozicion avokatët në një akt që të vazhdojë seanca por unë them ne do të vazhdojmë seancën sot.

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Megjithatë ka një dallim ndërmjet çfarë përfaqësuesit e partive politike prezantojnë me argumentet e tyre në lidhje me një çështje që shqyrtohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me atë çfarë pale apo subjekt i interesuar drejt për së drejti prezanton në një procedurë administrative në rastin konkret dhe i gjithë diskutimi këtu është nëse zonja avokate e përfaqëson apo nuk e përfaqëson zotin Beleri dhe e dyta nëse zoti Beleri ka marrë apo nuk ka marrë njoftim për këtë procedurë. Këto janë dy çështje nga ajo çfarë prezantoi avokatja unë kuptova se ajo nuk e ka tangerin ose nuk dëshiron ta përfaqësojë në të gjithë të drejtën e vet zotin Beleri. Ngelet të verifikojmë nëse ka njoftim për këtë zoti Beleri, gjithsesi ma jep pak aktin e përfaqësimit se nuk mendoj se është ndonjë çështje domethënëse është thjesht procedurale dhe nuk kemi asnjë arsye pse ta trajtojmë më shumë sesa e meriton. Në fakt nga akti i përfaqësimit e nderuar avokate rezulton se ju i keni të gjitha të drejtat dhe ai është në dijeni për këtë procesin dhe nëse më lejohet unë po e lexoj pastaj gjithësecili prej nesh këtu le ta kuptojë ashtu si e vlerëson. Sot në datën 03.07.2024 në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fier unë i

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

përfaqësuari Dhionisios Alfred Beleri i biri i Petros dhe Kasianit i datëlindjes 09.08.1972 lindur dhe banues në Himarë Vlorë me kombësi greke shtetësi shtetësi shqiptare dhe greke. Aktualisht duke kryer dënimin me burgim deklaroj me vullnetin tim si vijon: Me vullnetin tim të lirë emëroj avokate Klodiana Gjysarin me numër licence profesionale 12 mijë e 79 të Dhomës së Avokatisë Tiranë së cilës i jap këto të drejta të redaktojë, të nënshkruajë, të paraqesë për llogari time çdo kërkesë ankim kundërshtim të nënshkruaj çdo akt njoftim kërkesë e të tjera para dhe drejtuar çdo organi administrativ në Republikën e Shqipërisë. Të më përfaqësojë para çdo organi administrativ prokurori apo gjykate edhe në mungesën time si dhe të ushtrojë çdo të drejtë që Ligji Kodi i Procedurës Civile apo Kodi i Procedurave Administrative, Kodi Zgjedhor, Ligji për Gjykatat Administrative apo kushdo dispozit tjetër ligjore më ka njohur duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar në redaktimin dhe paraqitjen e kërkesave për përjashtim të trupit gjykues marrjen e akteve kundërshtimin e akteve e tjerë para çdo institucioni prokurorie apo gjykate në Republikën e Shqipërisë, përfshirë Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese. Avokati përfaqësues ligjor ka të drejtë të kryejë çdo veprim që të vlerësohem prej tij në përmbushje të objektit të kësaj prokure, ka të drejtë që pa praninë time të veprojë në emër dhe për llogarinë time për çdo veprim të nevojshëm e të dobishëm në vlerësimin e tij pa miratimin tim paraprak. Ky akti pasi lexohet nga përfaqësuesi gjendet sipas vullnetit të tij dhe nënshkruhet pa vërejtje. Unë mendoj që në këto rrethana ju i keni të gjitha të drejtat zonja avokate, për gjykimin dhe vlerësimin tim nuk është se do të kishte ndonjë dobi veçmas faktit nëse Beleri që e mirëkuptojmë, nuk kam pse ta fsheh ndoshta do të donte të thoshte diçka, por qëndruar strikt aspektit administrativ të shqyrtimit të kësaj çështje, unë mendoj që ne jemi në kushtet që mund të proçedojmë. Përndryshe nëse ju vetë nuk do të preferoni që ta përfaqësoni, atëherë kjo është një çështje tjetër

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

dhe e ndryshon komplet argumentin tim të deritanishëm. Kështu që ju vendosni e më thoni.

Znj.K.Gjysari(avokate): Bazuar në prokurën që ju cituat, unë paraqita edhe kërkesën që të lejohet të marrë pjesë zoti Beleri sepse dëshiron të flasë përpara KQZ-së, të njoftohet dhe të flasë para KQZ-së. Ai është në pamundësi absolute të vijë vetë. Duhet të njoftohet IEVP-ja, Drejtoria e Përgjithshme Burgjeve për shoqërimin e tij. Bazuar mbi aktin e përfaqësimit unë u paraqita sot dhe kam paraqitur edhe kërkesën që të lejohet të marrë pjesë kërkuesi në këtë seancë përpara KQZ-së. Ky ishte edhe qëllimi i paraqitjes së prokurës, që unë të nënshkruaja kërkesën që ai të lejohej të paraqitej në këtë gjykim administrativ, kjo është kërkesa.

Z.E.Salianji(Përfaqësues i PS-së): Kam një pyetje për administratën. Besoj se ky nuk është rasti i parë në gjykim administrativ. Unë këtu pyes administratën përse i përket procedurës së njoftimit, pavarësisht se filloi procedimi administrativ, si e gjykoni ju njoftimin për zotin Beleri, pra a keni pasur raste njoftimi në këtë procedure administrative a është njoftim si në të gjitha procedurat e tjera që ka bërë ky komision në lidhje me ligjet e dekriminalizimit? Përse i përket njoftimit, para se ne të vijmë në këtë sallë, bëhet njoftimi i partive politike. Administrata normalisht këtë e ka detyrë të vetën që të shikojë njoftimin. Tani, nuk e ka bërë administrata sepse e ka gjykuar me njoftimin publik të njoftohet, apo nuk ka qenë rasti që të bëhet njoftimi personalisht dhe është mjaftuar më njoftimin e zotit Kaso.

Z.I.Celibashi: Ne e kemi bërë njoftimin për këdo palë të interesuar në këtë process, por nuk jemi te diskutimi në lidhje me marrjen apo jo të njoftimit, sepse është e qartë që zoti Beleri ka marrë dijeni për seancën dhe për procesin që po zhvillohet.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

Diskutimi është sa legjitimitet ka kërkesa që zoti Beleri të prezantojë argumentet dhe qëndrimin e tij në këtë proces administrativ. Kështu është, apo jo zonja avokate.

Znj.K.Gjysari(avokate): Po, është njoftuar edhe avokati edhe me e-mail.

Z.I.Celibashi: Nuk e kemi vetëm çështjen e njoftimit në diskutim kështu që mos u merr me këtë gjë, nuk e kemi në diskutim çështjen e njoftimit. Njoftim kanë marrë, sepse zotërinjtë janë këtu, të gjitha palët. Diskutimi bëhet tani pasi sqaruar edhe çështjen e tagrit të përfaqësimit nga avokatja për interesin e zotit Beleri, për të paraqitur ai vetë personalisht pretendimet e tij në lidhje me këtë çështje.

Z.E.Salianji(Përfaqësues i PS-së): Përsa i përket kësaj pjese, pra shumë mirë që u sqarua pjesa e njoftimit, pra procesi i shqyrtimit administrative i është njoftuar të gjitha palëve, të cilët janë të interesuar në këtë proces. Atëhere këtu do të diskutojmë, kërkohet nga avokatja që zoti Beleri të jetë në sallë. Unë me sa shikoj vullnetin e zotit Beleri, ai thotë ose nëpërmjet avokatit, ose me shkresë. Në qoftë se nuk do të ishte në prokurë vullneti i tij, normalisht unë do të isha me kërkesën e avokates që të vazhdojë përfaqësimi që zoti Beleri të vijë në sallë, për arsye se nuk e ka këtë të drejtë. Prokura është e djeshme në prokurën që ju sapo lexuat i jep të gjithë të drejtat dhe në mungesë. Pra ajo çfarë kërkohet në këtë panelin tonë nuk është konform çfarë vetë zoti Beleri ka deklaruar në prokurë dhe atë çfarë zoti Beleri e ka dhënë tagër përfaqësimi ne duhet t'i qëndrojmë në mënyrë rigoroze. Mundet të kishim një letër nga zoti Beleri siç ndodh me një letër personale dhe të depozitoheshe nga avokatja në emër të zotit Beleri dhe të thuhej se unë do të marr pjesë në seancë, këtu as unë nuk flisja. Por ajo letër ka qenë e panevojshme për zotin Beleri se ai e ka bërë prokurën dhe I thotë avokates në një pikë të prokurës i ke të gjithë të drejtat dhe në

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

mungesën time. Tani avokates ia ka thënë që në mungesën time ti vazhdo procesin administrativ, avokatja këtë të drejtë që I ka dhënë zoti Beleri nuk do ta ushtrojë. Përderisa nuk do ta ushtroj unë them të vazhdojë procesi administrativ se vullnetin e zotit Beleri ju e keni me shkresë pra keni shkresën keni dhe deklarinimin.

Z.I.Celibashi: E kemi dhe kërkesën nga zoti Beleri me objekt lejimin e marrjes pjesë në seancën e datës 04.07.2024 ora 11:00 me rend dite e të tjera. I gjithë diskutimi ishte nëse avokatja e konsideronte në gjendje dhe jo vetëm nga pikëpamja profesionale, por nga pikëpamja procedurale dhe e përfaqësimit për ta ushtruar këtë përfaqësim apo jo. Mirë kemi gjë tjetër për këtë çështje?

Z.E.Salianji(Përfaqësues i PS-së): Unë them proces administrativ është një proces i cili nuk ka afat në shqyrtimin e tij ne jemi këtu me orar. Filluam tani dhe mund të vazhdojmë nuk çmoj se në vendimin tuaj në qoftë se unë kam për ta vazhduar seancën se tagërin e kam të plotë por në qoftë se ju çmoni që ta shtyni atëherë të merrni parasysh që ne sot të vazhdojë të bëhet njoftimi të jepen aktet dhe të lini një orar brenda ditës së sotme një orë dy orë në qoftë se ju do ta vendosni për mua ju do ta vazhdoni. Bëj këtë kërkesë se në qoftë se ju do të vendosni të kundërtën atëherë shtyrja duhet të bëhet me orë dhe nuk mund ta fusim këtë çështje në afate të cilat nuk ka kuptim, apo se kështu thotë ky proces.

Z.I.Celibashi: Keni gjë tjetër për këtë kërkesë? Nuk kemi.Unë vlerësoj që natyrisht për shkak të interes të ligjshëm të drejtpërdrejt që ka zoti Beleri në këtë proces si dhe për faktin që tej çdo rrethane tjetër të aspektit ligjor edhe pse jo domosdoshmërisht në një shqyrtim të kësaj natyre kërkohet prania e palës së drejtpërdrejt të interesuar apo dhe palët e tjera të interesuara megjithatë mendoj që

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

është e përligjur të kryhet mundësia që ai drejtpërdrejt t'i paraqesë pretendimet e veta në lidhje me këtë çështje edhe pse do të duhet ta theksoj, jo domosdoshmërisht kjo natyrë shqyrtimi i çështjes administrative apo një çështje administrative të kësaj natyre kërkon praninë e palës së interesuar për sa kohë ajo palë e kërkon mendoj se do të ishte e tepërt të paktën në cilësinë time si Komisioner Shtetëror të komentoja mbi arsyet apo motivet për këtë kërkesë. Në lidhje me kohën nuk besoj se kemi mundësi ta realizojmë sot.

Z.E.Salianji(Përfaqësues i PS-së): Pse nuk e zhvillojmë dot ne jemi në sallë, ju jeni në detyrë dhe normalisht keni detyrimin ta shqyrtoni këtë çështje. Zoti Beleri fatkeqësisht nuk është se ka punë tjetër, të njoftohet atje të llogarisë kohën njoftimi shoqërimi dhe ne brenda ditës sotme... Njoftimin e bëjmë se është dhe avokati këtu madje ka marrë dhe njoftim tani që të flasim thjesht do ndjekë procedurën sesi zoti Beleri do të vijë këtu.

Z.I.Celibashi: Pikërisht për këtë po diskutojmë do të duhet nga pikëpamja teknike ta mundësojmë këtë gjë. Ne këtu jemi dhe ne që jemi me shumë punë këtë punë kemi por çështja është si do ta realizojmë nga pikëpamja teknike.

Z.E.Salianji(Përfaqësues i PS-së): Atëherë merrni kohën e nevojshme shtyni 10 minuta seancën komunikoni..

Z.I.Celibashi: Nuk e di por ndoshta mund ta organizojmë të caktohet se kur por ndoshta duhet të vijë nga vendi vuajtjes së dënimit, të paraqitet fizikisht. Mund ta organizojmë dhe ndërmjet një platforme komunikimi elektronike.

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

Znj.K.Gjysari(avokate): Për mënyrën e procedurës është e drejta juaj të vendosni procedurën, për sa i përket afatit të shtyrjes mendoj se ditën e sotme është e pamundur për t'u zhvilluar për mendimin tonë duhet të lini një datë tjetër ose të urdhërohet shoqërimi i tij ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve fizikisht në seancë, ose t'i krijohen kushte në IEVP-në ku ndodhet por ditën e sotme kemi dhe angazhime të tjera ndoshta kolegu nuk ka angazhime të tjera por ditën e sotme ne kemi dhe angazhime të tjera dhe e kemi të pamundur për të vazhduar ditën stome seancën. Do të kërkonim një afat më të gjatë se përvecse kolegu ka katër ditë që i ka aktet ne i kemi parë në televizor aktet dje dhe na janë komunikuar me email ditën e djeshme pasdite, kurse klientit nuk i janë komunikuar fare. Kështu që duhet dhe ai t'i lexojë të shikojë bazën ligjore. T'i lihet një afat optimal të paktën aq sa i është lënë kolegut katër ditë që t'i lexojë.

Z.I.Celibashi: Nuk ka askush një document, nuk posedon në asnjë dokument më shumë se dikush tjetër dhe më parë se dikush tjetër kjo është pak po e sigurtë.

Znj.K.Gjysari(avokate): Unë u referova sa u shpreha që na është komunikuar para katër ditëve dhe mua dhe përfaqësuesit të PD-së.

Z.I.Celibashi: Njoftimi për seancën e datës sotme është publik.

Po zoti Sula!

Z.Sh. Sulo: Faleminderit zoti Komisioner. Unë gjykoj që në praktikën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka pasur raste të ngjashme dhe nuk ka ndodhur që të bëhet kaq shumë **temena** për një rast të tillë. Kemi aktin e përfaqësimit kemi vullnetin e shprehur i kemi të gjitha mundësitë. Nuk e kuptoj ku është aryeja që të presim të

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.04.07.2024*

paraqitet subjekti. Më duhet të theksoj se në momentin e regjistrimit apo dhe në kërkesat e tjera pranë këtij komisioni ky subjekt politik është përfaqësuar nga avokatë apo përfaqësues politike. Megjithatë duke parë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i zbatojë me përpikmëri më të madhe për këtë çështje unë do të sugjeroja që ditën e nesërme në orën 10:00 në çdo lloj formë që mund ta zgjidhë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për t'u bërë e mundur edhe dhënia e dëshmisë apo deklarata të këtij personi. Prandaj do të sugjeroja që shtyrja unë isha dakord me kolegun përfaqësuesin e PS-së që sot 7,8,19, 20 të bëjë kjo mbledhje se ndoshta mund të kërkohej dhe një shtyrje tjetër në bazë të vendimarrjes që ka KQZ-ja do të sugjeroja që nesër në orën 10:00 për të dhënë gjithë mundësinë palëve që të zhvillohej kjo seancë. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: E konsideruam të përligjur kërkesën për t'u dëgjuar i gjithë diskutimi është për kohën do ta bëjmë sot apo do ta bëjmë nesër. Kështu që nuk ka diskutim për thelbin e kërkesës së paraqitur. Atëherë për sot e mbyllim dhe seancën do ta lemë për ditën e nesërme për në orën 10:30. Ndërkohë do të shikojmë si do ta zgjidhim çështjen e pranisë së zotit Beleri apo për të mundësuar kërkesën e tij për të prezantuar ai personalisht pretendimet e veta në lidhje me këtë çështje. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Valbona UKCAMAJ*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

**04.07.2024
Ora 12:00**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, për subjektin vetëdeklarues z. Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.
- **Parti Politike:** PS (z. E. Salianji), PD (z. I. Kaso), PDIU (z. Sh. Sulo)
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Kalojmë me pikat e tjera të rendit të ditës.

Znj. P. Doçaj: Për sa i përket pikës së dytë të rendit të ditës “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, në lidhje me subjektin vetëdeklarues z. Gentjan Fiqiri Muça, anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”. Ky i fundit është propozuar nga ky subjekt, pra nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”, si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Ka dorëzuar formularin e dekriminalizimit dhe më pas nga ana jonë është kryer verifikimi pranë Zyrës së Gjendjes Civile dhe asaj Gjyqësore nga ku ka rezultuar i padënuar dhe ka rezultuar që ka një ndryshim në përbërësin e Gjendjes Civile nga

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

Gentian në Gentjan. Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është kryer verifikim i mëtejshëm në të dhënat e formularit të dekriminalizimit, nga ku ka rezultuar se në rubrikën 3, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka qenë i arrestuar nga organet ligjzbatuese në vitin 2011 nga shteti gjerman. Nisur nga këto rrethana Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e ka kaluar rastin për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Prokuroria e Përgjithshme pas miratimit të rezultatit të këtij verifikimi e ka dërguar vendimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezulton se subjekti vetëdeklarues nuk rezulton që të ketë ndryshime në përbërësit e gjendjes civile, nuk rezulton që të jetë i dënuar me një vendim penal të formës së prerë dhe nuk rezulton që të ketë asnjë vendim gjyqësor jo përfundimtar në ngarkim të tij. Nisur nga këto kushte, në referim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm, anëtari i Këshillit të Bashkisë Tiranë i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 dhe nuk është në kushtet e ndalimit apo moszgjedhshmërisë.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord. Atëherë vendosim sipas asaj çfarë relatuar duke:

- konfirmuar vazhdimin e mandatit për subjektin vetëdeklarues, z. Gentjan Muça, kandidat i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Vendimi nr. 66

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

04.07.2024
Ora 12:01

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë zj. Sanilje Reshit Salja”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.
Parti Politike: PS (z. E. Saliçani), PD (z. I. Kaso), PDIU (z. Sh. Sulo)
Të tjerë: **KRIIK**

Z. I. Celibashi: Po, vazhdojmë më tej.

Znj. P. Doçaj: Po. Për sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës. Komisioni Qendror Zgjedhjeve është bërë me dije nga Këshilli i Bashkisë së Vaut të Dejës me datë 13.05.2024 për krijimin e vakancës. Në referim të nenit 164 ka vijuar verifikimi i kandidatit në listën shumemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”. Është njoftuar për plotësimin e dokumentacionit kandidati dhe ka depozituar formularin e dekriminalizimit brenda afateve ligjore. Nuk rezulton nga të dhënat e formularit të dekriminalizimit që të jetë në kushtet e ndalimit. Është kryer verifikimi pranë zyrës së Gjendjes Gjyqësore dhe Gjendjes Civile dhe ka rezultuar që nuk ka ndryshime në përbërësit e Gjendjes Civile dhe nuk ka dënime penale në formë të prerë në ngarkim

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

të këtij kandidati. Për këtë arsye në referim të nenit 2 të ligjit, të dhënat e deklaruara nga kandidati nuk përbëjnë kusht për moszgjedhshmërinë e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur është projektvendimi përkatës.

Z. I. Celibashi: Atëherë vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, znj. Sanije Reshit Salja.

Vendimi nr. 67

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

04.07.2024
Ora 12:03

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjorë) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjekteve zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, i ndryshuar.”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Stafi KQZ: Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.

Parti Politike: PS (z. E. Salianji), PD (z. I. Kaso), PDIU (z. Sh. Sulo)

Të tjerë: KRIIK

Z. I. Celibashi: Po, kalojmë te pika e fundit e rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendimin “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 9.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurave për zgjedhjen, emërimin e ekspertëve kontabël, të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike, gjatë viti kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore.”, i ndryshuar.

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

Znj. J. Josifi: Po, faleminderit! Lidhur me pikën 4 të rendit të ditës, në zbatim të nenit 19, pika 1, shkronja “ë” dhe pikës 2 të të njëjtin nen të Kodit Zgjedhor, parashikohen kompetencat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, lidhur me të gjithë aspektet e financimit, fushatës zgjedhore si dhe nxjerrjen e akteve administrative në këtë drejtim. Nenet 92/6, 92/7 të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktojnë gjithashtu se auditimi i fondeve të shpenzimeve të fushatës zgjedhore si dhe mënyra e përzgjedhjes së ekspertëve kontabël, të licensuar apo audituesve ligjorë përcaktohet sipas rregullave të nxjerra nga KQZ-ja. Nenet 23/2 dhe 23/3 të ligjit “Për partitë politike”, të ndryshuar, ndërkohe përcaktojnë mënyrën e përcaktimit të ekspertëve kontabël auditues ligjor si dhe detyrimin e partive politike ndaj këtyre të fundit, të cilët caktohen nga KQZ-ja, për publikim e raporteve të auditimit nga koha e paraqitjes së raportit ose sipas rastit nga koha e mbylljes së procedurës së verifikimit dhe mënyrës së pagesës së audituesve. Në zbatim të sa më sipër ne kemi hartuar projektvendimin që është sot për shqyrtim nga ana juaj, qëllimi i të cilit është përkatësisht rishikimi i masës së shpërblimit për shërbimin e angazhimit të auditimit nga ana e audituesve ligjorë. Ne morëm shkak për këtë, për faktin se në tre vitet e fundit nga miratimi i këtij udhëzimi në qershor të vitit 2021, konteksti ka ndryshuar. Ne gjithashtu kemi vënë re se aplikimet që kemi pasur nga audituesit ligjorë për të qenë pjesë e këtij procesi kanë ardhur duke u ulur edhe për shkak të masës së shpërblimit për këtë shërbim auditimi, prandaj kemi propozuar një rritje, e cila konsiston në kalimin nga 0.3% në 0.4% të masës së shpërblimit, të vlerës së të gjithë të ardhurave të subjektit të audituar pa tvsh, të tjera të ardhura do të jenë gjithmonë të gjitha hyrjet të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta. Efektet financiare në buxhetin e shtetit që burojnë nga ky ndryshim i masës së shpërblimit, përballohen nga buxheti i KQZ-së dhe janë parashikuar në Programin Afatmesëm Buxhetor. Ndërkohë që pjesën tjetër për sa i takon auditimit

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 04.07.2024*

të raportimeve financiare vjetore mbulohet nga partitë politike që janë në këtë rast subjekte të audituara. Ne nuk kemi pasur sugjerime nga partitë politike për këtë projektvendim, kemi pasur kërkesë që kjo rritje, që ne po propozojmë sot, që është në masë relative prej 30% nga dy auditues ligjorë, të cilët kanë pasur bashkëpunim dhe vijnë të keni bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për auditime të jetë edhe më e madhe. Por në kushtet aktuale dhe kufizimet për sa i përket tavaneve buxhetore që ne kemi, kjo është masa që ne sot mund ta përballojmë dhe kjo është aq sa mund të bëjmë në këtë moment. Për sa më lart keni projektvendimin në vlerësimin tuaj.

Z. I. Celibashi: Ndërkohë e keni konsultuar me parti politike, organizata të shoqërisë civile dhe nuk keni pasur ndonjë koment prej tyre?

Znj. J. Josifi: Jo. Vetëm nga dy auditues ligjorë, siç e përmenda.

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Atëherë e meritojmë ndryshimin e udhëzimit nr.14, datë 9.06.2021, të Komisionerit Shtetëror sipas tekstit të projektaktit. Çështje të tjera nuk kemi. Mirë, seanca mbyllet. Ditë të mbarë! Faleminderit!

Vendimi nr. 68

*Zbardhi materialin audio
Adriana DUKA*

